

SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT SHIPKOVICA

f.Shipkovicë-Tetovë



STATUSI

www.kfshipkovic.mk

2020



Në bazë të nenit 18 të Ligjit për shoqata dhe fondacione 2010 („Gazeta zyrtare e RMV nr.52 /2010,,) dhe një vendimit për themelimin e Shoqatës, Shoqata e klubi i futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë , Tetovë, Shoqata Klubi i Futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë, kuvendi themelues i shoqatës, në mbledhjen e mbajtur më 26.04.2017 miratoi si në vijim:

STATUS

Shoqata

KLUBI I FUTBOLLIT SHIPKOVICA

f.Shipkovicë , Tetovë

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Është shoqatë vulnetare joqeveritare jopartiake dhe joprofitabile e formuar nga vullneti i lire i qytetarëve me qëllim të realizimit , mbrojtjes dhe harmonizimit të bindjeve dhe interesave për promovimin e shoqërisë civile nëpër bashkësitë lokale si dhe për kryerjen e veprimtarive dhe aktiviteteve të cilat i inkurajojnë vlerat morale forcimin e mardhënive ndërtnike dhe zhvillimit ekonomik në territorin e Maqedonisë së Veriut dhe më gjërë në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjin.

Neni 2

Qytetarët shoqërohen në shoqatë me qëllim të realizimit më të zgjeruar të interesave të përbashkëta në zhvillimin,përparimin dhe promovimin e sportit - futbollit të aktiviteteve sportive.

Neni 3

Shoqata klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë, vepron në territorin e RMV, dhe organizimin e veprimtarisë së saj e ka të përqëndruar territorin e komunës së Tetovës. Shoqata veprimtarinë e saj mund ta zgjeroj në mbarë vendin dhe mund të bashkëpunojë me organizata, shoqatat, fondacione dhe institucione dhe të antarsohet në shoqata në vend dhe jashtë vendit, në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Ligjin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe këtij Statusi.

Neni 4

Shoqata si një shoqatë me objektivat e saj , detyrat dhe aktivitetet do t'i realizoj në përputhje me raportet e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me këtë Status dhe me ligjet e R. Maqedonisë së Veriut.



Neni 5

- Emri i shoqatës së qytetarëve është në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe:
Здружение фудбалски клуб Шипковица с.Шипковица,Тетово
Shoqata klubi i futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë
- Emri i shkurtuar i Shoqatës është:
KF Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë - ФК Шипковица с.Шипковица ,Тетово
- Aktiviteti kryesor i shoqatës është:
93.12-Aktiviteti i klubeve sportive

Neni 6

Selia e shoqatës është në f.Shipkovicë në rr.101, organizohet dhe funksionon në zonën komunës së Tetovës, në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vendeve të tjera.

Neni 7

Shoqata klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë , Tetovë , ka statusin e një subjekti juridik me të drejta obligime dhe përgjegjësi që dalin nga ky status si dhe rregullat ligjore. Shoqatën klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë e përfaqëson **Kryetari**.

Shoqata ka vulën dhe stampën e vet

-Vula ka formën e rrumbullakët dhe përmban emrin e shoqatës së gjuhës maqedonase me alfabetin cirilik dhe në gjuhën shqipe , Здружение фудбалски клуб Шипковица с.Шипковица,Тетово - Shoqata klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë dhe në mes qëndron logoja e shoqatës .

-Stampa e Shoqatës ka formën e drejtkëndëshit me tekstin si vijon: Здружение фудбалски клуб Шипковица с.Шипковица,Тетово - Shoqata klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik dhe në gjuhën shqipe, numri , data dhe vëndi.



Qëllimet dhe detyrat e Shoqatës

Neni 8

Qytetarët shoqërohen në Shoqatën me qëllim të realizimit më të zgjeruar të interesave të përbashkëta në zhvillimin, përpelimin dhe promovimin e sportit - futbollit të aktiviteteve sportive.

Qëllimet themelore të shoqatës janë:

1. zhvillimi dhe përpelimi i sportit - futbollit dhe aktiviteteve sportive;
2. organizim dhe realizim të ndeshjeve të futbollit;
3. përpelimi, bashkëpunimi dhe zhvillimi me organizatat e tjera të futbollit;
4. realizimin e qëllimeve dhe detyrave të tjera të cilat do të përcaktohen ,plotësohen më tej me planet për punën e shoqatës;

Neni 9

Shoqata me vendim të posatshtëm mund të formoj shoqatë aksionare, shoqatë me përgjegjësi të kufizuar apo formë tjetër, sipas ligjit për kompani tregtare të R.Maqedonisë së Veriut. Shoqata punon në bazë të planit dhe programit të punës.

Neni 10

Shoqata i realizon qëllimet dhe objektivat e saj përmes programi të vërtetuar të punës, d.m.th. përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- organizimi i aktiviteteve konkrete të programore;
- zbatimi i projekteve të përbashkëta;
- organizimi i ndeshjeve të futbollit dhe aktiviteteve të llojeve të ndryshme;
- inkurajimin e një iniciative me autoritetet përkatëse dhe institucionet me qëllim të arritjes së qëllimeve të Shoqatës;
- kryerjen e detyrave të tjera të parapara me këtë Status.



Anëtarësimi

Neni 11

Antar i shoqatës klubi i futbollit Shipkovica , f.Shipkovicë Tetovë, mund të jetë çdo qytetar i moshës së rritur, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe / ose i huajit që vullnetarisht antarsohet në shoqatë duke dhënë deklaratë me shkrim.

Person mituri që ka mbushur 14 vjet mund të bëhet anëtar i shoqatës duke dhënë deklaratë me shkrim me pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor për anëtarësim në pajtim me ligjin.

Procesi i antarsimit në shoqatë bëhet me dhënjën e një karte të anëtarësimi, apo Librez Antarsimi e cila në rast të suspendimit , apo ndërprerjes së antarsimit në shoqatë detyrimisht duhet të kthehet duke dhënë deklaratë personale me shkrim .

Shoqata klubi i futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë për anëtarët e saj të mban regjistër të anëtarëve, e cila përditësohet çdo vit. Të dhënat nga regjistri mbrohen në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar.

Neni 12

Anëtari ka të drejtën zgjedh dhe të zgjidhet në organet e Shoqatës, të jetë pjesë përbërëse në punën e Shoqatës, të kontribuojë në zhvillimin, promovimin dhe popullaritetin e Shoqatës, të tërhiqet vullnetarisht nga anëtarësimi, ti shpreh pikëpamjet e tij pasi të parashtrihen pyetjet. E drejta për zgjedhje është e kufizuar vetëm për të mitur.

Neni 13

Anëtarët e Shoqatës janë të obliguar:

- të respektojnë Statusin,
- të marrë pjesë në takime, të paraqesë të dhëna dhe raporte për punën e Shoqatës në arritjen e qëllimeve të Shoqatës
- të marrë pjesë aktive në zbatimin e programit të aktiviteteve të Shoqatës,
- të kryejë aktivitetet e parapara në programin për Punës.



Neni 14

Anëtarësimi në Shoqatë mund të pushojë:

- me kërkesë të anëtarit të Shoqatës,
- nëse nuk respekton Statusin dhe detyrimet që rrjedhin prej saj,
- nëse vepron kundër qëllimeve të Shoqatës,
- nëse ai nuk paguan rregullisht antarsimin,

Vendimi për ndërprerjen e anëtarësisë në Shoqatë e sjell Kryetari Shoqatës.

Informimi i opinionit për punën e Shoqatës

Neni 15

Puna e Shoqatës Klubi i Futbollit Shipkovicë f.Shipkovicë, Tetovë është e hapur në raport me opinion publik .

Raporti i hapur me masën e gjërë për punën e shoqatës sigurohet me anë të njoftimeve të rregullta (anëtarëve, shoqatave të tjera ose publikut të gjerë). Mbi punën dhe aktivitetet e Shoqatës, me qëllim në zbatimin e detyrave të programit, duke paraqitur një raport për punën e organeve dhe trupave të Shoqatës, për veprimtarinë material / financiare dhe të ndryshme.

Për informimin e anëtarëve dhe të opinionit të gjërë shfrytëzohen shtypi, radio, televizion, mediat elektronike (faqeja e internetit), si dhe revista dhe tabela shpalljeve publike e cila qëndron në një vend të dukshëm në ambientet e vetë shoqatës.



Financimi i shoqatës

Neni 16

Shoqata siguron mjete nga:

- antarësimi,
- donacionet, kontributet vullnetare,
- buxheti i RM-së dhe i vetëqeverisjes lokale,
- ofrimin e shërbimeve për shoqata, organizata dhe institucionet e tjera,
- provizione nga organe, dhe organizata,
- bashkësi dhe institucionet e tjera,
- nga kompanitë tregtare dhe personat e tjerë juridikë,
- nga shërbimet e tjera (të drejtat e pronësisë, dhe të ngjajshme.),
- nga burime të tjera të parapara me ligj dhe status.

Neni 17

Përdorimi dhe disponimi i mjeteve të Shoqatës të marra në bazë të nenit të mëparshëm do të kryhet në mënyrën e përcaktuar me këtë Statut dhe norma të tjera ligjore të përcaktuara me planin financiar dhe në bazë të dokumenteve të vlefshme.

Neni 18

Organet e Shoqatës vendosin për përdorimin dhe shrytëzimin e fondeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë Statut, të cilët organe marrin masa gjithpërfshirëse ekonomike për shfytëzimit e mjeteve dhe për parandalimin dhe eliminimin e paregullsisë.

Neni 19

Shoqata klubi i futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë miraton planin vjetor financiar për të **ardhurat** dhe **shpenzimet** e shoqatës.

Plani financiar i përmban të hyrat e fituara sipas nenit 16 të Statusit, si dhe shpenzimet për veprimtarinë e përgjithshme shoqërore, pagat e punonjësve, materialet, shpenzimet për punën e shoqatës dhe shpenzimet e tjera që lidhen me punën e shoqatës. Plani financiar mund të ndryshohet në çdo kohë.



Organet e Shoqatës

Neni 20

Organet e Shoqatës klubi të futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë, Shoqata e Klubi të futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë janë:

1. Kuvendi

2. Kryetari

Kuvendi i shoqatës

Neni 21

Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës. Kuvendi i Shoqatës: Klubi i Futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë e përbëjn të gjithë anëtarët e moshës së rritur të Shoqatës.

Kuvendi zgjedh një President me mandate prej 4 vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje. **Kryetari** përfaqëson dhe prezenton Shoqatën.

Kuvendi mbledhet sipas nevojës dhe të paktën një herë në vit.

Neni 22

Kuvendi zgjedhore mbledhet çdo (4) katër vite dhe konstituimi i organeve dhe trupave punuese duhet të bëhet 30 ditë para skadimit të mandatit të anëtarëve të organeve dhe trupave punuese.

Ftesa me materialet e rendit të ditës me shkrim duhet të dorëzohet së paku 7 ditë para mbajtjes së seancës.

Neni 23

Kuvendi zgjedhor bën zgjedhjen e :

- Kryesisë së punës prej tre antarëve ;
- Nëpunësi për procesverbalin ;
- Dy vërtetues të procesverbalit ;
- Organet drejtuese të Shoqatës .



Neni 24

Kryetari i kuvendit i thërret seancat e kuvendit me vetëiniciativë. Seancat e kuvendit thirren gjithashtu me propozimin e 1/5 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit.

Nëse kryetari i kuvendit dështon të thërrasë një seancë brenda 14 ditëve nga data e propozimit të parashtruar, seancën e thërrasin nismëtarët.

Mënyra e thirrjes së seancave të kuvendit të Shoqatës përcaktohet me rregulloren e punës së kuvendit.

Neni 25

Kuvendi mund të marrë vendim të plotëfuqishëm në qoftë se janë të pranishëm më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Sipas rregulës kuvendi vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Në kuvend vendimet mirren me procedurën e votimit të hapur, por nëse është e nevojshme me propozimin e 1/3 e anëtarëve / delegatëve, poashtu votimi mund të bëhet në mënyrë të fshehtë, (në raste apostafate , gjatë parregullive e kështu me radhë).

Anëtarët e kuvendit duhet në gjithmonë qëllimet dhe interesat e shoqatës t'i kenë parësore mbi qëllimet individuale ose specifike të ndonjë pale tjetër.

Neni 26

Kuvendi kryen detyrat si vijon:

- miraton **Statusin** e shoqatës klubi i futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë, dhe bën ndryshimin dhe plotësimin e të tij;
- miraton raportin vjetor, kahjen dhe planin e punës;
- miraton bilancin vjetor dhe planin financiar;
- vendos për ndryshimin e qëllimeve të shoqatës;
- vendos për themelimin dhe heqjen e degëve dhe format e tjera të organizimit të shoqatës;
- vendos për bashkpunimin ose ndërprerje të bashkpunimit me një shoqatë tjetër, dhe për anëtarësim në lidhje dhe organizata ndërkombëtare;
- vendos për pranimin e anëtarëve të rinj dhe përfundim i anëtarësimit;
- zgjedh **Kryetarin** e shoqatës;
- miraton program për punën e shoqatës;
- ndjek gjendjen financiare e materiale të shoqatës ndërmjet dy mbledhjeve;
- debaton rezultatet e arritura nga zhvillimi i shoqatës dhe jep kahjen për zhvillimit e mëtutjeshëm të shoqatës;
- merr vendime, përfundime, rekomandime për zgjidhjen e çështjeve me interes të shoqatës;
- sjell vendim për ndërprerjen e shoqatës me shumicë prej dy të tretave të antarëve të shoqatës;
- poashtu kryen punë tjera që rrjedhin nga Statusi dhe ligjet.



Ndërprerja e punës së Shoqatës

Neni 27

Shoqata pushon së punuari në raste si vijon:

- Nëse shprehen 2/3 e anëtarëve të Asamblesë së Shoqatës ,
- Nëse numri i anëtarëve bie nën numrin e përcaktuar me ligjin për themelimin e Shoqatës,
- Nëse raste të paraqitjes së shkaqeve të parashikuara në nenin 63 të ligjit për shoqata dhe fondacione.

Vendimi për ndërprerjen e punës së Shoqatën e sjell **Kuvendi** me shumicën prej dy të tretave.

Themeluesit e Shoqatës klubi i futbollit SHIPKOVICA f.Shipkovicë, Tetovë mundë të vendosin për ndërprerjen e shoqatës.

Neni 28

Në raste të ndërprerjes së shoqatës, pasuria të drejtat tjera dhe të ardhurat e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve transferohen në pronësi të organizate identike me shoqatën..

Neni 29

Nëse nuk mund të plotësojnë kushtet e vërtetuara në nenin 28, në rast të ndërprerjes së punës të shoqatës pasuria e saj transferohet në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 30

Interpretimi i dispozitave të këtij statusi jepet nga **Kuvendi i Shoqatës**.

Neni 31

Ndryshimet në këtë Statut do të kryhen në përputhje me të njëjtën procedurë si për miratimin e tij.

Neni 32

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit të tij



Data dhe vendi :

Tetovë 26.04.2017

Kryetari i shoqatës :

KF SHIPKOVICA

f.Shipkovicë ,Tetovë

Hasan Fazlija
